



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par.1, pika b të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.07.2007, merr

V E N D I M
MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR
“SHESHIN E PAVARËSISË - PRESIDENT IBRAHIM RUGOVA”
NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi mbi caktimin e lokacionit për “Sheshin e Pavarësisë - President Ibrahim Rugova” në Prishtinë.

Lokacioni, nga par.1 i këtij neni, gjendet në mes bulevardit “Nëna Terezë” dhe rrugës “Agim Ramadani” në Prishtinë.

Neni 2

Ky vendim paraqet bazë për hartimin e dokumentacionit teknik për rregullimin e kësaj hapësire dhe vendosjen e shtatores së ish – presidentit Ibrahim Rugova.

Neni 3

Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë do të kryejë veprime procedurale nga përgjegjësia e tij për shënimin e lokacionit të caktuar sipas këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit të tij në Kuvendin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 353-305, më 24.07.2007

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri